

VENDIM

Nr.1180, datë 3.12.2009

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT TË AUTORIZUAR PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR "LOTARI KOMBËTARE"
DHE TË LICENCAVE PËR "KAZINO"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 pika 2, 27, pika 1, e 33 pika 2 të ligjit nr.10
033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i
Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti i autorizuar për dhënien e licencës për "Lotari kombëtare" dhe të licencave për "Kazino"
është Ministria e Financave.
2. Autorizohet Ministria e Financave për shpalljen e procedurave të garës për "Lotari kombëtare", si dhe
për shpalljen e kriterëve për dhënien e licencave për "Kazino".
3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha